



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



Anr.600/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Luan Vocaj nga Peja, kandidat për asamble të Kuvendit Komunal në Pejë, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.2114-2021 të datës 28.08.2021, për shkak të largimit nga lista e kandidateve për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2021, si kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Gjakovë, në seancën e panelit të mbajtur me 03.09.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**HUDHET** i pasafatshëm apeli Anr.600/2021 i datës 02.09.2021, i parashtruar nga Luan Vocaj nga Peja, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Pejë, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.2114-2021 të datës 28.08.2021, për shkak të largimit nga lista e kandidatëve për anëtar të Kuvendit Komunal, për pjesëmarrjen në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 17 Tetor 2021.

### A r s y e t i m

Me datën 02.09.2021 PZAP-i ka pranuar një apel nga Luan Vocaj nga Peja, kandidat për asamble të Kuvendit Komunal në Pejë, në të cilin pretendon se KQZ, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikim të gabuar të së drejtës materiale. Gjithashtu ka theksuar se vendimi i KQZ është i padrejtë për faktin se kandidat Luan Vocaj është dënuar me gjobë dhe të njëjtën gjobë e ka paguar, ndërsa sipas dispozitave ligjore ky dënim nuk ka pasoja juridike. Me propozim që i njëjti vendim të ndryshohet dhe parashtruesit të kësaj ankesë ti lejohet e drejta në certifikimin për kandidim për asamble komunale. Parashtruesi krahas apelit ka bashkangjitur si dëshmi dëftesën e pagesës së dënimit me gjobë dhe dokumentin e identifikimit.

PZAP-i me datën 02.09.2021 ka dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kërkesën për përgjigje në ankesë.

Zyra për Regjistrimin e Partive Politike ZRPPC-KQZ ka dërguar përgjigjen në ankesë më datën 03.09.2021, në të cilën theksohet se sa i përket parashtruesit të apelit Luan Vocaj kandidat për anëtar në Kuvendin Komunal të Komunës së Pejës, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për Pejë, me datë 20.08.2021 është kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që ti sigurojë KQZ-së emrat e individëve nga lista e kandidatëve të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) të cilëve me anë të vendimit të gjykatës iu është hequr e drejta për të qenë kandidat apo që janë

shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit. Me datë 23.08.2021, ka pranuar shkresën nga KGJK, me të cilën, ndër të tjera është identifikuar edhe ky kandidat me të dhëna si në vijim: Luan Vocaj është i dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm P-111/2019 të datës 23.09.2019. Zyra përmes personit kontaktues ka komunikuar me subjektin politik PDK duke i njoftuar për të gjeturat, duke i kërkuar që të njëjtin ta zëvendësoj në të kundërtën zyra do ti rekomandoj KQZ-se për mos certifikimin e tij. Subjekti politik PDK nuk ka sjellë zëvendësimin për këtë kandidat por ka sjellë listën pa këtë emër. KQZ ka certifikuar listën e kandidateve të PDK-se pa z. Luan Vocaj me datën 28 gusht 2021 me vendimin e KQZ-se nr. 2114/2021

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së apelit, gjeti se:

#### **Apeli është i pasafatshëm**

Paneli pas vlerësimit paraprak të apelit, ka gjetur se apeli i parashtruar nga kandidati për asamble komunale në komunën e Pejës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) Luan Vocaj, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së, me nr. Nr.2114/2021, të datës 28.08.2021, me të cilin vendim është certifikuar lista e kandidatëve të subjektit politik PDK, për asamble komunale, Paneli ka gjetur se apeli i paraqitur është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën 122 par. 1 të LZP-së, ku përcaktohet: *“Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilat do vendime të KQZ-së, mund të apelojë atë vendim në PZAP brenda (24) orëve”*. Në këtë rast KQZ-ja, e ka certifikuar listën e kandidatëve të subjektit politik PDK, me datë 28.08.2021, ndërsa apeli ndaj vendimit për certifikim është paraqitur në PZAP me datë 02.09.2021, që rezulton të jetë pas afatit ligjor sepse afati për apele ka qenë 24 (njëzetekatër) orë nga marrja e vendimit të KQZ-së, bazuar në dispozitën ligjore të nenit 122 paragrafi 1 të LZP-së.

Paneli gjeti se i njëjti është i ushtruar pas afatit ligjor, që rezulton të jetë i pasafatshëm, dhe për atë arsye nuk u lëshua në përmbajtjen-vendosjen meritorë të këtij apeli.

Nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 115 paragrafi 1, neni 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
A.nr. 600/2021 më datën 03.09.2021.

Kryesues i Panelit  
Adnan Konushevoi



#### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.